



Forumi për Iniciativa Qytetare



BUXHETI I POLICISË SË KOSOVËS

Nevojat për buxhet shtesë dhe
planifikim më të mirë financiar

Mars, 2012 Prishtinë

Buxheti i Policisë së Kosovës – nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar

Prishtinë, mars 2012

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Instituti për Studime të Avancuara
GAP

Kjo analizë e politikave është përgatitur nga hulumtuesit e Institutit për Studime të Avancuara GAP në projektin: “Rritja e angazhimit të shoqërisë civile në përmirësimin e ofruesve të sigurisë në Kosovë”, implementuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), dhe financuar nga NED.

Prishtinë, mars 2012

Hyrje

Me instalimin e administratës ndërkombëtare civile në Kosovë, filluan edhe përpjekjet për themelimin dhe konsolidimin e sektorit të sigurisë. Megjithëse, sipas Rezolutës 1244, barra për ruajtjen e sigurisë dhe rendit iu dha misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, në të njëjtën kohë u punua edhe në themelimin dhe konsolidimin e Shërbimit Policor të Kosovës. Më 6 shtator 1999 nën menaxhimin e OSBE-së filloi zyrtarisht ngritja e kapaciteteve policore vendore. Me shtimin e kapaciteteve administrative dhe operacionale dalëngadalë kompetencat ekskluzive që atëbotë i kishte policia e UNMIK-ut filluan të kalojnë tek ato vendore. Me shpalljen e pavarësisë, më 17 shkurt 2008 si dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi Policinë më 4 qershor 2008¹ kompetencat e rezervuara të këtij sektori kaluan edhe zyrtarisht tek autoritetet vendore. Për herë të parë u emërua edhe Drejtori i Përgjithshëm i policisë.

Procesi i konsolidimit të Policisë së Kosovës ka shënuar përparime të dukshme përgjatë këtyre viteve. Me ngritjen e kapaciteteve të saj janë shtuar edhe kompetencat dhe përgjegjësitë e policisë në ruajtjen e rendit dhe ligjit. Sot, Policia e Kosovës ka të punësuar gjithsejtë 8.546 punonjës (të uniformuar dhe staf civil) dhe ka një buxhet vjetor prej afro 79 milionë euro.

Konsolidimi dhe ngritja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të Policisë së Kosovës në masë të madhe varet edhe nga buxheti i përgjithshëm i ndarë për këtë sektor të rëndësishëm të sigurisë. Në këtë studim Instituti për Studime të Avancuara GAP analizon buxhetin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, atë aktual dhe buxhetin ndër vite duke filluar nga viti 2009 e këndeje. Analizimi i buxhetit të policisë është një ndër faktorët kryesor drejt ballafaqimit me sfidat që e presin këtë organizatë të sigurisë.

Buxheti i përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për Policinë e Kosovës është i domosdoshëm në mënyrë që funksionimi i këtij sektori të sigurisë dhe rendit publik të jetë në nivelin e duhur. Nga Buxheti i Kosovës për vitin 2012 prej gjithsej 1.508.912.003 euro, për Policinë e Kosovës është paraparë një buxhet i përgjithshëm prej 78.712.708 euro.

¹ Ligji nr.03/L-035 për Policinë e Kosovës, shpallur në Gazetën Zyrtare më 4 qershor 2008. Ligji mbi Policinë ishte pjesë e listës së ligjeve të Pakos së Ahtisaarit lidhur me transferimin e kompetencave tek organet shtetërore pas shpalljes së pavarësisë.

Në këtë tabelë është paraqitur ndarja e buxhetit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës për vitin 2012.

Kategoritë e shpenzimev	Të punësuarit në vitin 2012	Pagat dhe Mëditjet	Mallrat dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Shpenzimet Kapitale	Buxheti i Përgjithshëm
Buxheti i PK në €	8.546	€50.097.264	€10.673.444	€1.567.000	€470.000	€15.905.000	€78.712.708
Buxheti i PK sipas %	/	63.7%	13.5%	2.0%	0.6%	20.2%	100%

Nga kjo tabelë mund të vërehet se më shumë se gjysma e buxhetit të policisë shkon për paga dhe mëditje, apo 63.7% të shpenzimeve të përgjithshme. Kategoria e dytë që përbën pjesën më të madhe të shpenzimeve është kategoria shpenzimet kapitale me afërsisht 20.2% të kompozicionit të përgjithshëm.

Nëse e krahasojmë buxhetin e Policisë së Kosovës për vitin 2012 me vitet paraprake, del se buxheti i vitit 2012 është më i larti ndonjëherë. Përderisa në vitin 2009 buxheti i Policisë ishte rreth 55 milion euro, në vitin 2012 Policia disponon një buxhet prej rreth 79 milion euro. Tabela e më poshtme tregon lëvizjen e buxhetit për secilën kategori ndër vite.

BUXHETI I POLICISË SË KOSOVËS

nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar

Në këtë tabelë është bërë krahasimi i buxhetit të policisë ndër vite dhe përqindja e rritjes në raport me vitet paraprake.

	Të punësuarit	Pagat dhe Mëditjet	Mallrat dhe Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencione t dhe Transferet	Shpenzimet Kapitale	Buxheti i Përgjithshëm
Buxheti 2009²	9.077	€28.529.154	€11.050.000	€1.600.000	€100.000	€13.500.000	€54.779.154
Buxheti 2010³	9,077* (↔)	€39.698.697 (28.1% ↑)	€10.989.821 (0.55% ↓)	€1.600,000 (↔)	€100.000 (↔)	€10.646.300 (26.8% ↓)	€63.034.818 (13.1% ↑)
Buxheti 2011⁴	8,547 (↓)	€50.302.229 (21.1% ↑)	€10.639.569 (3.3% ↓)	€1.567.000 (2.1% ↓)	€100.000 (↔)	€12.173.274 (12.5% ↑)	€74.782.072 (15.7% ↑)
Buxheti 2012⁵	8,546 (↓)	€50.097.264 (0.4% ↓)	€10.673.444 (0.3% ↑)	€1.567.000 (↔)	€470.000 (470% ↑)	€15.905.000 (23.5% ↑)	€78.712.708 (5.0% ↑)

Tabela e më sipërme tregon se buxheti i përgjithshëm i ndarë për Policinë e Kosovës ka shënuar rritje nga viti në vit. Megjithatë, sa i përket kategorive në këtë buxhet vërejmë një luhatje nga viti në vit sikurse te kategoria *Paga dhe Mëditje* ku në vitin 2011 buxheti ishte më i madh se ai i vitit 2012 për 204.965 euro apo me rreth 0.4%. Mesatarja e rritjes prej vitit 2009 të buxhetit të përgjithshëm, nga viti në vit, është 11.3%.

Në ilustrimin më poshtë janë paraqitur grafikisht rritja/zvogëlimi i shpenzimeve të buxhetit të përgjithshëm dhe dy kategorive më të mëdha buxhetore.

² Buxheti i Kosovës 2009.

³ Buxheti i Kosovës 2010.


⁴ Buxheti i Kosovës 2011.

⁵ Buxheti i Kosovës 2012.


* Shënim: Siç mund të vërehet në tabelën nr.2, sipas Buxhetit të vitit 2009 dhe 2010 numri i të punësuarve në Policinë e Kosovës ishte 9.077 ndërsaq në vitet në vazhdim ky numër është ulur në 8.547 me fillimin e reformave në strukturimin dhe riorganizimin e Policisë nga menaxhmenti i lartë.

BUXHETI I POLICISË SË KOSOVËS

nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar



Buxheti i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për vitin 2012 është mbi 99 milion euro, ku 79.3% e këtij buxheti ndahet për Policinë e Kosovës, kurse pjesa tjetër për shërbimet e administratës së MPB, Inspektoratin Policor, Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, etj.



Buxheti i Policisë luan rol esencjal në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të saj. Sipas Ligjit për Policinë, policia është e obliguar që ta mbrojë jetën,

sigurinë dhe pronën e të gjithë personave, ta parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike, t'i parandalojë dhe zbulojë veprat penale, të ofrojë ndihmë dhe mbikëqyrje për sigurinë në komunikacion, si dhe përgjegjësi të tjera të parapara me ligj. Për përmbushjen e këtyre obligimeve Policisë së Kosovës i nevojitet edhe motivim personal por edhe mjete të nevojshme logjistike.

Ngritja e pagave në fillim të vitit të kaluar prej 40% nga ana e Qeverisë së Kosovës mund të ketë shtuar motivimin e pjesëtarëve të policisë. Në të vërtetë pjesa më e madhe e buxhetit të policisë (63.7% të totalit të buxhetit) është e ndarë për paga dhe mëditje. Rreth 51 milion euro janë të destinuara për paga dhe mëditjet e gjithsej 8.546 të punësuarve në Policinë e Kosovës. Vlen të përmendet se numri prej 8.546 punonjësish është numri i të punësuarve të lejuar sipas Buxhetit të 2012. Mirëpo, në praktikë, Policia e Kosovës ka të punësuar 8.458 punonjës dhe planifikon të punësoj edhe 88 punonjës të rinj për të përmbushur kuotën e lejuar të të punësuarve. Prej stafit aktual në Policinë e Kosovës, 7.333 janë pjesëtarë të uniformuar dhe 1.125 staf civil.

Përkundër asaj se 63.7% e buxhetit të PK shkon për paga dhe mëditje, PK nuk ka sigurim shëndetësor dhe as sigurim jetësor. Duke marrë parasysh natyrën e punës së policisë, PK ka nevojë urgjente që të ketë sigurim shëndetësor dhe jetësor.

Për mbajtjen e sigurisë dhe rendit në Kosovë, si dhe për luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të tjera nevojiten mjete të caktuara logjistike dhe trajnime profesionale. Të gjitha këto bartin një kosto të lartë buxhetore. Posaçërisht për luftimin e krimit të organizuar nevojiten mjete të konsiderueshme financiare, çështjet operacionale sikurse në rastet e simulimit të prostitucionit, simulimit të blerjes së drogës nga agjentë të fshehtë, pagesës së informatorëve, programit për mbrojtjen e dëshmitareve, etj.

Aktualisht Policia e Kosovës ka rreth 1.350 automjete, në mesin e tyre vetëm një top uji. Për shkak se një pjesë e madhe e automjeteve të policisë i janë dhënë kësaj të fundit në formë të donacioneve nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, Policia e Kosovës ka rreth 90 lloje të ndryshme të automjeteve.⁶ Edhe pse që nga viti 2009 Policia e Kosovës nuk ka blerë asnjë veturë, kostoja e mirëmbajtjes dhe riparimit të tyre është shumë e lartë, kjo edhe për faktin e shumëllojshmërisë së veturave. Përveç se nevojiten mjete financiare për blerjen e veturave, një kosto të madhe shkon edhe për ripërtëritjen, ndërrimin e veturave për shkak të dekonspirimit, mirëmbajtjen e automjeteve të ashtuquajtura të fshehta pa shenja policore për nevoja të vëzhgimit. Së bashku me stacionet policore, veturat policore përbëjnë investimin më të madh kapital për Policinë e Kosovës. Veturat e policisë

⁶ Intervistë me z.Hamdi Hyseni, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Policinë e Kosovës, 6 mars 2012.

duhet të pajisën me një varg pajisjesh operacionale dhe dokumente. Sipas raportit të Inspektoratit Policor, vetura duhet të ketë radio, fikës zjarri, ndihmën e parë, gomën rezervë dhe veglat për ndërrimin e gomës, trekëndësh sinjalizues dhe zinxhirë apo goma dimri. Po ashtu vetura duhet të posedojë dokumente për qarkullim, si polisën e sigurimit, formularin për servisim, formularin për prishje të veturës, formularin për udhëtim dhe formularin për raport të aksidentit. Inspektorati ka vërejtur se në 26 stacione asnjë nga veturat e inspektuara nuk ka qenë e pajisur me të gjithë pajisjet dhe dokumentet e kërkuara.⁷

Për shkak të numrit të madh të veturave të aksidentuara të policisë, në raportin e Inspektoratit shprehet një pakënaqësi e madhe rreth performancës së policëve dhe rekomandon të rishikohet planprogrami i trajnimit dhe të vlerësohen aftësitë për vozitje të policëve kohë pas kohe. Në vitin 2008 kanë ndodhur 193 aksidente kurse në vitin 2009 gjithsej 230 aksidente kanë ndodhur me vetura zyrtare të policisë, me ose pa fajin e policëve. Që do të thotë se niveli i aksidenteve është rritur për 19.2%. Edhe pse të gjitha automjetet janë të siguruara dhe në rast të aksidenteve kompania e sigurimeve mbulon shpenzimet e dëmeve, prapë se prapë numri i madh aksidenteve krijon shpenzime shtesë për PK.⁸

Në përgjithësi mjetet e ndara për mallra dhe shërbime janë të pa mjaftueshme në raport me nevojat aktuale të policisë. Për vitin 2012 janë ndarë afër 10.7 milion euro për këtë kategori. Me ngritje e çmimeve të karburantit është ngritur edhe kostoja e përgjithshme e policisë për këtë kategori. Në vitin 2011 janë shpenzuar gjithsej 4.704.120 euro për derivate dhe lëndë djegëse, dukshëm më shumë se në vitin 2010 kur ishin shpenzuar gjithsej 3.619.971 euro.⁹

Ngritje të kostos ka edhe në aspektin e lobimit të zyrtarëve të lartë të Kosovës nga Presidenca edhe nga Qeveria. Shpenzimet e pjesëtarëve të policisë të cilët shoqërojnë zyrtarët shtetëror në vizita jashtë vendit duhet të mbulohen nga buxheti i policisë. Shoqërimi i zyrtarëve shtetëror bartë një kosto të madhe për buxhetin e policisë. Gjithashtu, që nga fundi i vitit 2011 Policia e Kosovës ka marrë përgjegjësinë e kontrollimit të kufirit me Malin e Zi, dhe tashmë ajo kontrollon e vetme kufijtë edhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Kjo përgjegjësi ia ka rënduar edhe më shumë buxhetin e Policisë së Kosovës. Nga fondi për mallra dhe shërbime prej 10.7 milion euro janë të parapara mjete për:

⁷ Inspektorati Policor i Kosovës. Raport mbi inspektimin e jashtëzakonshëm nr.2/2010. (Raport of extraordinary inspection No. 2/2010, General Evaluation of Managerial Performance of Police Stations, Police Inspectorate of Kosovo)

⁸ Policia e Kosovës ka ndërmarrë një masë e cila ngarkon Policët që të paguajnë 20% të dëmeve të shkaktuara, në rast se një komision vlerësues i ngritur për të hetuar rastin, gjen se aksidenti ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së policit.

⁹ Intervistë me z. Hamdi Hyseni, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Policinë e Kosovës, 6 mars 2012.

- shërbime administrative (176.264 euro),
- operacione (264.249 euro) dhe operacione speciale (186.893 euro),
- hetime (169.841 euro),
- shërbimet e mbështetjes (8.827.185 euro),
- trajnime (339.494 euro),
- policia kufitare (248.446 euro),
- drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve (240.000),
- menaxhmenti (221.072 euro).¹⁰

Mungesa e helikopterëve dhe autobлиндave

Pas aksionit policor për marrjen nën kontroll të pikave doganore në Jarinjë dhe Bërnjak, mediat raportonin se kryeministri ka në plan që të kërkojë leje nga Kuvendi për të blerë pajisje të sofistikuara për Policinë e Kosovës, dy helikopterë dhe dhjetë automjete të blinduara. Plani për përfundimin e logjistikës dhe të operativës së Policisë, është dashur t'i prezantohet Kuvendit, në sesionin vjeshtor të punës. "Në bazë të studimit që është bërë nga Policia dhe nga MPB, ka dalë se dy helikopterë dhe 10 autobлиндa janë të mjaftueshme në këtë kohë. Por meqë vlera e tyre mund të kalojë 25 për qind të buxhetit të përgjithshëm të MPB-së, atëherë në bazë të ligjeve në fuqi duhet që vendimin përfundimtar për këto blerje ta japë Kuvendi i Kosovës. Vlera e mjeteve që planifikohen të blihen parashihet të arrijë mbi 20 milionë"¹¹.

Kështu, në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm nuk do të ketë shumë investime kapitale edhe këtë vit. Edhe pse ishte paraparë që këtë vit Policia e Kosovës të blejë dy helikopterë, kjo nuk do të ndodh për shkak të buxhetit të pa mjaftueshëm. Kosova ka nevojë të madhe për helikopterë dhe kjo jo vetëm për Policinë e Kosovës, por edhe për reagime emergjente. Zyrtarë të lartë të qeverisë thonë se helikopterët do të përdoren për menaxhimin e situatave emergjente, sikurse ishte sfida e fundit e Policisë së Kosovës në veri të vendit. Megjithatë, helikopterët mund të hynë në punë edhe në raste të tërmeteve, ortekëve të borës, menaxhimin e zjarreve, kërkim shpëtimi, kontrollin e kufirit, menaxhimin e turmave dhe trafikut nga ajri, ndjekjen në raste të kidnapimeve, transportin e njërive speciale, etj. "Kosova ka nevojë për gjashtë helikopterë, edhe pse për momentin do të ishin të mjaftueshëm tre", ka thënë një zyrtar qeveritar, duke shtuar se një helikopter i lehtë mund të kushtojë nga 800 mijë deri në 1 milion e 600 mijë euro, kurse një helikopter i mesëm mund të kushtojë nga 8 deri në 14 milionë euro"¹².

¹⁰ Buxheti i Kosovës për vitin 2012.

¹¹ Koha Ditore, Qeveria e do policinë me helikopterë e autobлиндa, 20 gusht 2011.

¹² Gazeta Zëri, 22 shtator 2011.

Edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në lidhje me domosdoshmërinë e pajisjes së pjesëtarëve të policisë me mjete që shërbejnë në menaxhimin e operacioneve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë pati pranuar se pajisjet ekzistuese nuk mjaftojnë në raport me kërkesat dhe nevojat operative që ka PK-ja, prandaj është planifikuar që në kuadër të buxhetit të vitit 2012 të blihen automjete speciale, armatim, municion, pajisje teknologjike, etj.¹³ Këto vështirë se do të realizohen gjatë vitit 2012. Po ashtu edhe dizajnimi dhe blerja e uniformave të reja vështirë se mund të realizohet për shkak të kostos së lartë.

Përveç kufizimeve buxhetore, blerja e helikopterëve vështirësohet edhe nga obligimet ndërkombëtare dhe procedurat e komplikuar që duhet të ndjek Policia e Kosovës.¹⁴ Por në rast të blerjes së helikopterëve, PK duhet të blejë së paku dy helikopterë të të njëjtit lloj, njërin për të shërbyer, kurse tjetrin rezervë dhe si zëvendësim në rast të prishjeve të cilat mund të ndodhin.¹⁵ Blerja e helikopterëve dhe autobindave, përveç që paraqet një kosto të madhe buxhetore si investim kapital, bartë edhe kosto të tjera, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje dhe trajnim të përdoruesve të kësaj makinerie.

Kufizimet buxhetore dhe sfidat për përmbushjen e synimeve

Policia e Kosovës përveç detyrave dhe obligimeve të cilat i parasheh Ligji për policinë, tani më i ka vënë vetës edhe një varg objektivash të tjera. Sipas Planit Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2011-2015¹⁶ të aprovuar nga ministri i Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës brenda kësaj periudhe synon të realizojë shtatë objektiva kryesore për organizatën:

- parandalimi i krimit;
- lufta kundër krimit të organizuar;
- kontrolli, mbikëqyrja, parandalimi dhe luftimi i krimit ndërkufitar përmes Menaxhimit të Integruar të Kufirit;
- zhvillimi i organizatës përmes menaxhimit të performancës;
- modernizimi dhe standardizimi i organizatës;
- bashkëpunimi dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare në parandalimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit;
- dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare.

¹³ Revista mujore e Policisë së Kosovës, "Mbrotjtësi", Vëllimi VII, nr. 3.

¹⁴ Deklarimi i zëvendësministrit të MPB z.lzmi Zeka, në tryezën e Forumit për Iniciativa Qytetare dhe Institutit GAP me rastin e diskutimit të draft-analizës për "Buxhetin e Policisë së Kosovës", 20 mars 2012.

¹⁵ Agim Musliu, prezentim në tryezën e Forumit për Iniciativa Qytetare dhe Institutit GAP me rastin e diskutimit të draft-analizës për "Buxhetin e Policisë së Kosovës", 20 mars 2012.

¹⁶ Plani Zhvillimor i miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme në fillim të vitit 2011, për shkak të natyrës së ndieshme, mbetet konfidencial për publikun.

Realizimi i këtyre objektivave krahas nevojës për organizim më të avancuar, kërkon edhe mjete shtesë buxhetore. Buxheti i vitit 2012 për policinë është mjaft i kufizuar dhe nuk lejon shumë hapësirë për arritjen e këtyre objektivave sikurse që është për shembull modernizimi dhe standardizimi i organizatës.

Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2015 nuk përmban planifikim të duhur dhe të saktë të buxhetimit për secilin aktivitet që nevojitet për të përmbushur shtatë objektivat strategjike të parapara me Planin Zhvillimor Strategjik. Nga 120 aktivitetet e parapara me Planin Zhvillimor Strategjik për periudhën 2011-2015, 64 aktivitete nuk përmbajnë fare koston buxhetore, për 39 aktivitete tjera është cekur se shpenzimet do të jenë administrative apo se janë të buxhetuara, një aktivitet parashihet të mbështetet nga donatorët (nuk ceket shuma dhe burimi) dhe vetëm 16 aktivitete përmbajnë shuma të sakta buxhetore. Totali i shpenzimeve për implementimin e 16 aktiviteteve, për të cilat janë paraparë shpenzimet e sakta buxhetore, është 31.9 milion euro. Kjo lë të kuptohet se në Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2015, Policia e Kosovës nuk ka arrit të kalkulojë koston reale të aktiviteteve.

Me qëllim të zbatimit më të drejtë të Planit Zhvillimor Strategjik 2011-2015, PK në bashkëpunim me MPB, nevojitet që të saktësojnë edhe kostot e përafërta për secilin aktivitet të paraparë për përmbushjen e objektivave strategjike 2011-2015. Përndryshe, mos saktësimi i kostos së planit zhvillimor pamundëson PK të justifikojë kërkesën për fonde shtesë përmes MPB tek MEF.

Edhe sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2012-2014, një ndër objektivat strategjike të MPB është ngritja e kapaciteteve të policisë, në veçanti në fushat që kanë të bëjnë me hetimin dhe zbulimin e krimit të organizuar, korrupsionit si dhe integrimi në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale. Ngritja e kapaciteteve të policisë nënkupton:

- Vëzhgimi dhe hetimi i veprave të rënda kriminale dhe qasje në luftimin e krimeve në teknologjinë informative;
- Luftimi i krimeve ekonomike përmes ngritjes së kapaciteteve institucionale për luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare;
- Mundësia e përdorimit të metodave për vëzhgim gjatë hetimeve, me qëllim të marrjes së provave për ndjekje penale;
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore, posaçërisht në sektorin e luftimit të pastrimit të parasë, hetimit të narkotikeve dhe aftësia për luftimin e korrupsionit;
- Luftimi i krimit të organizuar përmes përmirësimit të bashkëpunimit bilateral dhe integritimit në organizata relevante ndërkombëtare dhe rajonale.
- Shtrirja e sistemit të inteligjencës në të gjitha nivelet, rritja e kapaciteteve të nevojshme për përgjim ligjor të telekomunikimeve;

- Ndër projektet kapitale të MPB-së për periudhën 2012-2014 parashihen edhe ndërtimet dhe renovimet e stacioneve policore, blerja e veturave të blinduara dhe topave uji.

KASH 2012-2014 nuk përmban një linjë të veçantë për buxhetin e Policisë së Kosovës, por përmban vetëm buxhetin e MPB-së.

Performanca dhe organizimi i Policisë së Kosovës është kritikuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011. Në seksionin ku flitet për sfidat dhe të arriturat e Policisë së Kosovës, thuhet që ka pasur ngecje nga ana e këtij institucioni në aspektin e shmangies nga ndikimi politik i cili ka qenë evident në emërimin e zyrtarëve të lartë si dhe në udhëheqjen e operacioneve të ndjeshme. Në raport gjithashtu thuhet që është shënuar përparim i kufizuar në lidhje me zbatimin e metodologjisë së policimit në bashkësi; është evidentuar mungesa e kontakteve të vazhdueshme në mes të kësaj të fundit dhe komiteteve për siguri në bashkësi; stacionet e reja policore nuk janë hapur në komunat e themeluara në bazë të Pakos së Ahtisarit; janë evidentuar sfida serioze në menaxhimin e burimeve njerëzore; si dhe është vërejtur mungesa e kapaciteteve të shtyllës për operacione në planifikim strategjik dhe aftësi analitike.¹⁷

Nëse i marrim për bazë konstatimin e Komisionit Evropian si dhe obligimet që dalin nga Planin Zhvillimor 2011-2015, duhet të theksohet se buxheti aktual është një pengesë serioze në arritjen e këtyre synimeve. Pesë kategoritë e tjera që janë të ndjeshme brenda buxhetit të policisë, hetimet, shërbimet e mbështetjes, trajnimet, policia kufitare dhe drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve, kanë buxhet tepër të vogël për të bërë të mundur realizimin me sukses të objektivave të lartshënuara¹⁸.

Në tabelën më poshtë paraqitet buxheti i policisë, gjegjësisht ndarja buxhetore për kategoritë që u përmendën më lartë.

	Kategoritë	Mallrat & Shërbimet	Shpenzimet Komunale	Shpenzimet Kapitale
Buxheti i Policisë së Kosovës 2012	Hetimet	€169,841		€2,715,000
	Shërbimet e Mbështetjes	€8,827,185	€1,567,000	€6,654,000
	Trajnimet	€339,494		€150,000
	Policia Kufitare	€248,446		€1,126,000
	Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve	€240,000		€240,000

¹⁷ Raporti i Progresit për Kosovën 2011, faqe 56-57.

¹⁸ Intervistë me Sekretarin e Përgjithshëm të MPB-së, z. Ilhami Gashi.

Këto kategori konsiderohen esenciale në përmbushjen e synimeve të Policisë së Kosovës të dala nga Raporti i Progresit 2011 si dhe nga Planin Zhvillimor 2011-2015.

Krahasimi i buxhetit të Policisë së Kosovës me shtete e rajonit.

Shteti	Pjesëmarrja në buxhetin total
Maqedonia	6,44%
Serbia	4,47%
Mali i Zi	4,84%
Shqipëria	3,97%
Kosova	5.22%

Menaxhimi financiar dhe nevoja për decentralizim të buxhetit të PK

Hartimi dhe ekzekutimi i buxhetit të Policisë së Kosovës është proces tejet i centralizuar. Me buxhetin e PK menaxhon Ministria e Punëve të Brendshme. Raporti i fundit i publikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, gjen shumë mangësi sa i përket mënyrës së ekzekutimit të buxhetit nga ana e MPB dhe PK. Mangësitë në menaxhimin e buxhetit të PK kanë të bëjnë me: shfrytëzimin e të hyrave vetanake të destinuara për mirëqenien e policëve, mangësi në procesin e prokurorit, mos largimi me kohë nga lista e pagave të punëtorëve të larguar nga detyra, etj.¹⁹

Një nga nën objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik 2011-2012 është edhe përmirësimi i sistemit financiar. PK parasheh ta bëjë këtë duke: decentralizuar buxhetin e PK dhe plotësimin dhe hartimin e procedurave të nevojshme për menaxhimin financiar në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Kjo do të mundësonte decentralizimin e vendimmarrjes dhe planifikimit në bazë të specifikave të rajoneve/stacioneve dhe do t'i zvogëlonte edhe procedurat burokratike të cilat ndikojnë negativisht dhe mund ta rrezikojnë efikasitetin e operacioneve. Megjithatë, Plani Zhvillimor Strategjik nuk parasheh afat të saktë kohorë se kur duhet të përfundohej procesi i decentralizimit të buxhetit të PK.

¹⁹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MPB-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, <http://oag.rks-gov.net/Raportet%20shqip/2010/Ministrite/RaportiAuditimit%20MPB%202010%20Shqip.pdf>

Përfundime

- Buxheti i Policisë së Kosovës, megjithëse i kufizuar, ka shënuar rritje nga viti në vit. Rritja mesatare prej vitit 2009 e deri më tani ka qenë 11.3%.
- Kategoritë që më së shumti “përfitojnë” nga buxheti i përgjithshëm i Policisë së Kosovës janë *Pagat & Mëditjet* (63.7%) dhe *Shpenzimet Kapitale* (20.2%). Por edhe më tutje, PK-së i mungon sigurimi shëndetësor dhe ai jetësor.
- Plani Zhvillimor Strategjik 2011-2015, përcakton shtatë objektiva të qartë për tu arritur deri më 2015, mirëpo ky dokument është i paplotë ngase nuk përmban planifikim të duhur buxhetor. Kategoritë si: hetimet, shërbimet e mbështetjes, trajnimet, Policia Kufitare dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve mbeten me buxhet tejet të kufizuar.
- Policia e Kosovës shpenzon shumë në mirëmbajtjen e flotës së saj, e cila përbëhet prej rreth 90 automjeteve të llojeve të ndryshme, të cilat janë vjetruar, nuk janë mirëmbajtur dhe shpenzojnë tepër për shkak të tipeve të prodhimit (shumica e tyre janë automjete aziatike).

Rekomandime

- Përballja me sfidat si rritja e kapaciteteve profesionale dhe logjistike në luftimin e llojeve të ndryshme të krimeve të ndërlikuara kërkon rritjen e buxhetit për shpenzimet kapitale gjatë përgatitjeve për rishikimin e buxhetit në mesin e dytë të këtij viti.
- Për përmbushjen e synimeve që dalin nga Plani Zhvillimor 2011-2015 nevojitet rritje a kapaciteteve profesionale dhe logjistike që nënkupton rritje e buxhetit për kategorinë e hetimeve si dhe për shpenzimet kapitale.
- Vëmendje e madhe duhet t’i kushtohet departamentit të hetimeve të forenzikës dhe departamentit për hartimin dhe analizimin e politikave ku rritja e buxhetit duhet të zë vend gjithsesi.

- Policia Kufitare ka rol kyç në luftimin e krimit të organizuar dhe buxhetit të këtij sektori duhet t'i jepet prioritet. Buxheti i tanishëm nuk i plotëson nevojat i këtij sektori as për së afërmi.
- MPB dhe Qeveria në përgjithësi duhet të ndajnë më shumë mjete buxhetore për PK me qëllim të përmbushjes së objektivave që dalin nga Planin Zhvillimor 2011-2015 i PK, por edhe prioriteve qeveritare për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ngritja e buxhetit për PK do të dëshmonte përkushtimin qeveritar dhe vullneti politik të deklaruar.
- MPB dhe Policia e Kosovës duhet të plotësojnë Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2015, duke plotësuar vijat buxhetore që nevojiten për përmbushjen e objektivave të vëna me këtë plan.
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2013-2015, përveç planifikimit trevjeçar për buxhetin e MPB, duhet të ketë një planifikim më të saktë të buxhetit afatmesëm edhe për Policinë e Kosovës.
- PK duhet të ketë një strategji të qartë se si të unifikoj flotën e saj, duke larguar automjetet e reja dhe duke u pajisur me automjete të cilat operojnë me më pak shpenzime dhe janë më uniforme.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Forumi për Iniciativa Qytetare

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare që punon në sektorin e sigurisë, zhvillimit të filantropisë dhe mbështetjes përmes granteve të projekteve për qytetari aktive dhe mbrojtje mjedisi.